

Tiranë, më 10.08.2026

Nga: Shoqëria “Mabco Constructions” S.A., një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Zviceran, regjistruar në regjistrin tregtar me numër CHE-101.624.994, me seli në adresën: Via Cattori 7, 6902, Paradiso, Lugano, Zvicër, përfaqësuar nga Presidenti i Shoqërisë Z. Emin Pacolli.

Lënda: 1. Kundërshtim i zgjidhjes së parakohshme të Kontratës së Koncesionit;
2. Kërkesë për fillimin e negociatave në mirëbesim për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Baza ligjore: Nenet 10.17, 10.68, 11.1, 11.4, 11.7, 11.9, 13.1, 13.3, 13.4, 15.4, 16 dhe 21 të Kontratës së Koncesionit;

Drejtuar: **Z. Enea Karakaçi**
Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë

Për dijeni: **Z. Odise Moçka**
Avokat i Përgjithshëm i Shtetit

I nderuar Z. Karakaçi,

Më datë **03.08.2026**, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (“**MIE**”) ka njoftuar zgjidhjen e parakohshme të Kontratës së Koncesionit, duke pretenduar, ndër të tjera, se Shoqëria Koncesionare ka kryer shkelje thelbësore të detyrimeve të saj kontraktore, të lidhura kryesisht me mosrealizimin e Data e Operimit brenda afatit kontraktor, mospërfundimin e punimeve dhe mosvënien në operim të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, mospërmbushjen e detyrimit për sigurimin e Kontratës, si dhe me vonesat dhe problematikat që, sipas MIE-së, kanë karakterizuar zbatimin e projektit. MIE i ka konsideruar gjithashtu si elemente që justifikojnë zgjidhjen e Kontratës konfliktet ndërmjet ortakëve të Shoqërisë Koncesionare dhe Marrëveshjen e Huadhënies të lidhur me Delphos Securities, duke arritur në përfundimin se janë përmbushur kushtet e parashikuara në nenin 15.4 të Kontratës dhe duke ushtruar, mbi këtë bazë, të drejtën për zgjidhjen e parakohshme të saj. Megjithatë, pretendimet e MIE-së janë të pabazuara, dhe zgjidhja e kontratës jo vetëm që është e paligjshme por edhe konsiston në një Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar.

Në shkresën e saj, MIE e mbështet zgjidhjen e parakohshme të Kontratës së Koncesionit, në thelb, në pretendimin se është përmbushur një prej rasteve të parashikuara në nenin 15.4 të Kontratës, përkatësisht: mosrealizimi i Datës së Operimit brenda afatit kontraktor [A.]. Gjithashtu, MIE pretendon se si shkelje materiale të Kontratës mospërmbushjen e detyrimit të mbajtjen në fuqi të Sigurimit të Kontratës [B.]; si dhe mospagesa e penaliteteve kontraktore nga Shoqëria Koncesionare [C.]. Megjithatë, pavarësisht bazës kontraktore të invokuar prej MIE-së, në vlerësimin e Mabco-së, zgjidhja e njëanshme dhe e parakohshme e Kontratës së Koncesionit, në rrethanat në të cilat ajo është ndërmarrë, nuk përbën një ushtrim të ligjshëm të së drejtës kontraktore të MIE-së, por konsiston në një tjetër Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar [D.].

A. Në lidhje me pretendimin e MIE-së për mos përfundimin e punimeve

Në njoftimin e saj, dhe në vijim të qëndrimit të përsëritur, por të pabazuar në Kontratën e Koncesionit dhe në kuadrin ligjor të zbatueshëm, MIE vijon t'ia atribuojë dështimin për përfundimin e fazës së ndërtimit brenda afatit kontraktor ekzistencës së konflikteve të "natyrës civile" ndërmjet ortakëve të Shoqërisë Koncesionare. Ky qëndrim është i pabazuar si në fakt, ashtu edhe në ligj. MIE jo vetëm që ka qenë në dijeni të plotë dhe të vazhdueshme të situatës, por, në kundërshtim me detyrimet e saj sipas Kontratës së Koncesionit, ka lehtësuar krijimin dhe përshkallëzimin e kësaj situate dhe më pas ka zgjedhur të qëndrojë pasive përballë veprimeve të paligjshme që pengonin zbatimin e projektit, pavarësisht se këto rrethana i janë bërë të ditura në mënyrë të përsëritur përmes më shumë se 90 shkresave drejtuar MIE-së ose nëpërmjet të cilave MIE është vënë në dijeni. Për më tepër, ky qëndrim nuk përbën thjesht një interpretim të Mabco-së mbi marrëdhënien ndërmjet palëve. Por, më datë 26.05.2026, Gjykata e Lartë ka konfirmuar se marrëdhënia ndërmjet Shoqërisë Koncesionare dhe ortakëve të saj nuk është thjesht tregtare, por Autoriteti Kontraktor ka detyrimin pozitiv për të vepruar me qëllim mbrojtjen e interesit publik. Për rrjedhojë, mosrespektimi nga MIE i këtij vendimi dhe i interpretimit të dhënë prej organit më të lartë gjyqësor në vend, si dhe vijimi i qëndrimit të saj pasiv përballë rrethanave që penguan zbatimin e projektit, në asnjë rast nuk mund t'i atribuohet si faj Mabco-së apo Shoqërisë Koncesionare. Përkundrazi, përfundimi i punimeve brenda afatit kontraktor është penguar drejtpërdrejt nga Veprimet Materiale të Pafavorshme Qeveritare. Në këtë kuadër, MIE keqinterpreton edhe vetë natyrën e situatës, duke e reduktuar atë në një "konflikt ndërmjet ortakëve", ndërkohë që çështja thelbësore qëndron në faktin se, përballë rrethanave që pengonin zbatimin e Kontratës së Koncesionit, MIE kishte detyrimin kontraktor dhe ligjor për të vepruar, por zgjodhi të mosveprojë, në kundërshtim me detyrimet që i ngarkoheshin në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

MIE pretendon se ndodhet në kushtet e nenit 15.4 të Kontratës së Koncesionit, me argumentin se mospërmbushja e detyrimeve kontraktore nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktues. Ky pretendim është i pabazuar. Sipas interpretimit sistematik të Kontratës, në përputhje me nenet 682 dhe 683 të Kodit Civil, përjashtimi i parashikuar në nenin 15.4 nuk mund të lexohet i shkëputur nga detyrimet e tjera kontraktore të MIE-së, veçanërisht nga neni 13 dhe garancia e parashikuar në nenin 11.9 (*Vazhdimësia*). Edhe nëse shprehja "*një veprim ose mosveprim të Autoritetit Kontraktues*" në nenin 15.4 i referohet drejtpërdrejt veprimeve ose mosveprimeve të MIE-së, kjo nuk e çliron MIE-në nga përgjegjësia për mosveprimin e saj përballë veprimeve të organeve të tjera shtetërore që kanë penguar zbatimin e Projektit. Përkundrazi, neni 11.9 i Kontratës garanton që asnjë Autoritet Kompetent nuk do të ndërmarrë veprime me efekt material të pafavorshëm ndaj Projektit, ndërsa neni 13.1 e përkufizon shprehimisht një Veprim Material të Pafavorshëm Qeveritar si veprim ose mosveprim të Autoritetit Kontraktues ose të çdo Autoriteti Kompetent që ndikon materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme të drejtat, aktivet ose të ardhurat e Koncesionarit. Në këto kushte, veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore, përfshirë gjykatat, QKB-në, Policinë e Shtetit apo Avokaturën e Shtetit, të cilat kanë penguar realizimin e Projektit, përbëjnë Veprime Materiale të Pafavorshme Qeveritare dhe, në kushtet kur MIE ka qenë në dijeni të tyre dhe ka dështuar të ndërhyjë për t'i parandaluar ose korrigjuar, përbëjnë edhe mosveprim të Autoritetit Kontraktues në kuptim të nenit 15.4. Kjo përputhet edhe me nenin 13.4, sipas të cilit një Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar përbën mospërmbushje të Kontratës nga MIE dhe aktivizon të drejtat e Koncesionarit, përfshirë ato sipas nenit 16 (*Dëmshpërblimi*). Për rrjedhojë, MIE nuk mund të mbështetet në një mospërmbushje të cilën veprimet ose mosveprimet e saj, të marra në kontekstin e veprimeve të organeve të tjera shtetërore, e kanë shkaktuar ose kanë kontribuar materialisht në krijimin e saj. Një interpretim i kundërt do të binte gjithashtu ndesh me parimin e mirëbesimit të parashikuar në nenet 682 dhe 422 të Kodit Civil dhe me qëllimin e përbashkët të palëve në kuptim të nenit 681 të Kodit Civil. Për më tepër, neni 15.6(b), i cili parashikon të drejtën e Koncesionarit për zgjidhjen e Kontratës në rast të një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar sipas nenit 13.3, konfirmon se



nenet 13 dhe 15 janë pjesë e një mekanizmi kontraktor të integruar dhe nuk mund të zbatohen në mënyrë të shkëputur. Për rrjedhojë, për sa kohë që mospërbushja e pretenduar nga MIE është shkaktuar ose rënduar nga Veprime Materiale të Pafavorshme Qeveritare, kushtet e nenit 15.4 nuk janë përmbushur dhe zgjidhja e Kontratës mbi këtë bazë është e parakohshme dhe e pabazuar.

Në më shumë se 90 shkresa të adresuara MIE-së, Mabco ka paraqitur në mënyrë të detajuar situatën me faktet dhe grup-faktet, provat mbështetëse dhe bazën ligjore që qëndron në themel të secilës prej shkëljeve të konstatuara, duke kërkuar ndërhyrjen e menjëhershme të Autoritetit Kontraktues për marrjen e masave të nevojshme me qëllim rivendosjen e ligjshmërisë, garantimin e zbatimit të Kontratës së Koncesionit dhe përmbushjen e detyrimeve që burojnë prej saj, nga legjislacioni në fuqi për koncesionet, si dhe nga kuadri ndërkombëtar për mbrojtjen e investimeve të huaja, përfshirë Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për Nxjitjen dhe Mbrojtjen Reciproke të Investimeve. Në këtë kuadër, është e rëndësishme të theksohet se përgjegjësia e Autoritetit Kontraktues nuk kufizohet vetëm në garantimin e vijimësisë formale të marrëdhënies kontraktore, por përfshin edhe detyrimin pozitiv për të mbrojtur Koncesionarin nga çdo cenim, pengesë apo ndërhyrje e paligjshme që dëmton realizimin e Projektit. Ku më konkretisht:

- 1) Nga data 17.10.2025, deri më datë 26.05.2026, për më shumë se 7 muaj, nëpërmjet vendimeve gjyqësore për sigurimin e padisë **[(i) Vendimi nr. 996 regj. them. datë 17.10.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (ii) Vendimi nr. 17959, datë 23.12.2025, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë; (iii) Vendimi nr. 30-2026-1569, datë 19.02.2026, i Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm]**, të drejtat e votës së Mabco-së, ortakut me 98% të kuotave të shoqërisë koncesionare u pezulluan, vendime të cilat më pas u shpallën të paligjshme nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 338, datë 26.05.2026;
- 2) Më datë 05.06.2026, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, ka rikthyer gjendjen e konstatuar si të paligjshme nga Gjykata e Lartë, duke vendosur përsëri një masë të re të sigurimit të padisë, duke kufizuar në thelb të drejtën e votës së Mabco-së, 1 ditë përpara thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve **[Vendimi i datës 05.06.2026 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për marrjen e masës së sigurimit të padisë]**. Edhe pse kjo masë e gjerë u zëvendësua më 06.07.2026 me një masë më të ngushtë, të përqendruar te mosaderimi i VIA-së në marrëveshjen e financimit me Delphos dhe te mosdisponimi i kuotave të kontestuara, deri në atë datë ajo kishte penguar normalizimin e administrimit dhe zhvillimin e mbledhjes së datës 06.06.2026. Për më tepër, efekti praktik i përjashtimit të Mabco-së vijoi edhe pas ngushtimit të masës, për shkak të moszbatimit të vendimeve të Asamblesë dhe të mbështetjes së palëve të treta vetëm te regjistrimi i Vegim Hoxhës në QKB.
- 3) Nga data 11.12.2025, për më shumë se 8 muaj, shoqëria koncesionare administrohet nga administratori i emëruar nëpërmjet vendimit absolutisht të pavlefshëm të ortakut të minorancës, shoqëria “2A Group” sh.p.k., e cila ka vetëm 2% të kuotave të shoqërisë, në kushtet kur kuorumi për marrjen e vendimeve të vlefshme, referuar nenit 86 të ligjit nr. 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, është pjesëmarrja e ortakëve me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 30% të kuotave. Ky vendim absolutisht i pavlefshëm është regjistruar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (institucion në varësi të Ministrisë së Ekonomisë dhe Inovacionit) **[Çështja me nr. CN-553010-12-25, datë 15.12.2025]**, dhe që nga momenti i regjistrimit të këtij vendimi, administratori i emëruar nga ortakut me 2% të kuotave, Vegim Hoxha, ka vepruar në emër të Shoqërisë me kompetencë të plotë;
- 4) Pengimi i paligjshëm i aksesit në kantier, rrezikimi i pronës dhe ndërprerja e punimeve nga veprimet dhe mosveprimet e Policisë së Shtetit. Policia e Shtetit, në vend që të garantonte ushtrimin e ligjshëm të të drejtave të Mabco-së dhe vijimin e punimeve në kantier, ka lejuar dhe, në raste konkrete, ka



penguar hyrjen e përfaqësuesve, punonjësve, inxhinierëve dhe specialistëve të Mabco-së në kantier, duke mos marrë masat e nevojshme për parandalimin dhe ndërprerjen e situatës së kundërligjshme që çoi në përjashtimin faktik të Mabco-së nga kantieri dhe në bllokimin e vijimësisë së punimeve. Në veçanti, ndonëse efektivët e Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë ishin fizikisht të pranishëm më datat 18 dhe 19 maj 2026, ata nuk garantuan hyrjen e rreth 200 punonjësve, inxhinierëve dhe specialistëve të Mabco-së në kantier dhe nuk ndërhyjnë për të ndaluar pengimin e tyre, edhe pasi u vunë në dijeni të vendimit të Gjykatës së Lartë të datës 26.05.2026. Përkundrazi, Policia vijoi të refuzonte ndërhyrjen, me arsyetimin se çështja duhej të zgjidhej nga gjykata, duke lejuar kështu vazhdimin e një situatë të kundërligjshme që pengonte drejtpërdrejt ushtrimin e të drejtave të Mabco-së dhe vijimin e punimeve. Ky veprim dhe mosveprim bie në kundërshtim me detyrimet pozitive të parashikuara në nenin 9, pika 1, shkronjat “b” dhe “ç”, të ligjit nr. 82/2024 “Për Policinë e Shtetit”, për garantimin e paprekshmërisë së pronës private dhe parandalimin, hetimin dhe zbulimin e veprave penale, si dhe me nenin 10, pika 1, që detyron punonjësin e policisë të parandalojë veprimet ose mosveprimet e kundërligjshme dhe të ndërhyjë menjëherë për ndërprerjen e pasojave të tyre. Për rrjedhojë, përgjegjësia e Autoritetit Kompetent (Policia e Shtetit), si dhe Autoritetit Kontraktues, nuk qëndron vetëm në mosreagimin ndaj situatës, por edhe në faktin se, duke mos garantuar dhe duke penguar në mënyrë faktike aksesin e Mabco-së në kantier, ato kontribuan drejtpërdrejt në ndërprerjen e punimeve dhe në pasojat që vijuan për Projektin.

- 5) Lejimin e shoqërisë së sigurimit “Global Security” sh.p.k., subjekt i licencuar dhe i ushtrimit të veprimtarisë së të cilit mbikëqyret nga autoritetet shtetërore shqiptare, të pengojë dhe bllokojë aksesin e Mabco-së në Aeroportin Ndërkombëtar të Vlorës, pa asnjë bazë ligjore apo vendim gjyqësor, pavarësisht Vendimit të Asamblesë së Ortakëve të VIA-së, datë 18.06.2026, si organit më të lartë vendimmarrës të shoqërisë, i cili kishte urdhëruar lejimin e aksesit të Mabco-së në kantier pa pengesa, si dhe pavarësisht vendimit të Asamblesë për zgjidhjen e kontratës së shërbimit me shoqërinë e sigurimit. Për më tepër, “Global Security” sh.p.k. ka vijuar të ushtrojë veprimtarinë e sigurimit fizik në kantier pa një kontratë të vlefshme me VIA-në dhe pa miratimin paraprak me shkrim të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 18 të ligjit nr. 75/2014 “Për Shërbimin Privat të Sigurisë Fizike”, ndërkohë që Policia e Shtetit, pavarësisht dijenisë mbi mungesën e dokumentacionit dhe autorizimeve përkatëse, ka lejuar vijimin e këtij aktiviteti, dhe në cenim të të drejtave të Mabco-së;
- 6) Avokatura e Shtetit, në kundërshtim me kompetencat dhe funksionin e saj ligjor, ka ndërmarrë veprime në procesin gjyqësor të iniciuar nga ortaku me 2% të kuotave, duke kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë. Avokatura e Shtetit ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë duke u mbështetur në një rrezik hipotetik të aderimit të VIA-së në marrëveshjen e financimit me Delphos, ndonëse neni 16.6 i Statutit të VIA-së, neni 23.2 i marrëveshjes së financimit, si dhe neni 19.3 i Kontratës së Koncesionit e kushtëzojnë një veprim të tillë me miratimet përkatëse, ndërsa vendimi i Gjykatës së Lartë ka konfirmuar se çdo vendosje në garanci e pasurive të Aeroportit pa miratimin e Shtetit është absolutisht e pavlefshme. Pavarësisht kësaj, pasi kërkesa e Avokaturës së Shtetit nuk u pranua nga gjykata, ajo e ka ankimuar këtë vendim, edhe pas vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të datës 18.06.2026, i cili, në bazë të nenit 81, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 9901/2008 dhe nenit 12 të Statutit, ndalonte çdo veprim për aderimin e VIA-së në marrëveshjen e Delphos. Gjithashtu, ndërhyrja e Avokaturës së Shtetit në proces duhet vlerësuar në dritën e neneve 90 dhe 191 të Kodit të Procedurës Civile, pasi ajo ka ndërhyrë për të mbështetur një palë private në një proces ku MIE nuk ishte palë, ndërkohë që masa e sigurimit kërkohej në kundërshtim me interesat e Mabco-së dhe VIA-së. Ndonëse kërkesa për marrjen e masës së sigurimit të padisë së kërkuar nga Avokatura e Shtetit nuk është pranuar, kanë qenë pretendimet e saj, dhe rreziku i invokuar nga ky Autoritet



- Kompetent, të cilat janë bërë shkak që Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, më datë 05.06.2026, të pranonte kërkesën e ortakut me 2% të kuotave;
- 7) Mabco ka paraqitur në mënyrë të përsëritur kallëzime penale pranë organeve kompetente lidhur me veprime të dyshuara të kundërligjshme që prekin administrimin dhe funksionimin e shoqërisë koncesionare, që prej datës 20.10.2025. Pavarësisht përsëritjes dhe rëndësisë së kallëzimeve, në dijeninë e Mabco-së, hetimet nuk kanë përfunduar, ndonëse neni 323, pika 2, të Kodit të Procedurës Penale, parashikon se afati i zakonshëm për përfundimin e hetimeve paraprake është tre muaj dhe, në dijeninë e Mabco-së, nuk është marrë ndonjë vendim për zgjatjen e tij në përputhje me nenin 324 të këtij Kodi. Veprimet objekt kallëzimi vijnë të prodhojnë pasoja të drejtpërdrejta mbi funksionimin e VIA-së dhe zbatimin e projektit të Aeroportit Ndërkombëtar të Vlorës, ndërkohë që punimet mbeten të bllokuara, specialistëve dhe nënkontraktorëve të Mabco-së u mohohet akses, pajisjet dhe infrastruktura ekspozohen ndaj dëmtimeve të mëtejshme dhe pasojat ekonomike e kontraktuale, që tashmë llogariten në dhjetëra milionë euro, vijnë të rëndohen çdo ditë.
 - 8) Mosangazhim i MIE-së, në kundërshtim me nenet 11.4 dhe 11.9 të Kontratës së Koncesionit, ndaj kërkesave të Mabco-së për zhvillimin e takimeve zyrtare, duke e kufizuar në praktikë mundësinë e saj për t'u dëgjuar, për të paraqitur qëndrimet, shqetësimet dhe provat lidhur me zbatimin e Projektit. Ndër të tjera, më datë 12.01.2026, Mabco njoftoi MIE-në se përfaqësuesit e saj, Fadil Neziri dhe Afrim Aziri, ishin penguar të merrnin pjesë në një takim të zhvilluar në kantier, ndonëse në të ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë; më datë 04.03.2026, pas raportimit të pengesave të vazhdueshme për aksesin, Mabco kërkoi zhvillimin e një takimi urgjent institucional me MIE-në; më datë 10.05.2026, Mabco kërkoi sërish zhvillimin e një takimi urgjent pranë MIE-së/NZP-së për diskutimin e përfundimit të terminalit dhe punimeve të mbetura; më datë 12.05.2026, në një shkresë drejtuar NZP-së dhe me MIE-në në dijeni, Mabco evidentoi se përfaqësuesit e saj nuk ishin pritur nga institucionet përkatëse. Mabco është përballur me përjashtim, mospranim të kërkesave, mungesë përgjigjeje dhe pengesa procedurale, duke i mohuar në praktikë mundësinë efektive për t'u dëgjuar dhe për të paraqitur në kohë qëndrimin dhe provat e saj pranë Autoritetit Kontraktor;
 - 9) Pavarësisht se Mabco e kishte vënë në mënyrë të përsëritur MIE-në në dijeni për kontestimin e vlefshmërisë së administrimit dhe të tagrave përfaqësuese të personave të emëruar nga "2A Group" sh.p.k., MIE ka vijuar të angazhohet institucionalisht me këta persona, ndërkohë që Mabco, ortak i mazhoritar me 98% të kuotave të VIA-së, financuesi dhe garantuesi kryesor i Projektit, është përjashtuar nga ky angazhim. Ndër të tjera, më datë 15.12.2025, Mabco kundërshtoi emërimin e Vegim Hoxhës si administrator të VIA-së nga "2A Group" sh.p.k., duke vënë në dyshim kompetencën e tij për të përfaqësuar shoqërinë; më datë 08.01.2026, Mabco njoftoi MIE-në, Kryeministrin dhe QKB-në se emërimi i kontestuar, së bashku me konfliktin mbi pronësinë e kuotave, kishte sjellë paralizimin e administrimit të VIA-së; më datë 02.02.2026, Mabco kërkoi ndërhyrjen institucionale dhe kundërshtoi shprehimisht veprimet e "2A Group" sh.p.k. dhe të administratorit të kontestuar; ndërsa më datë 06.02.2026, Mabco kundërshtoi interpretimin sipas të cilit masat gjyqësore e kishin privuar atë nga statusi i ortakut apo nga e drejta për të komunikuar me institucionet shtetërore. Gjithashtu, Mabco ka informuar vazhdimisht MIE-në për pengesat teknike, operacionale dhe administrative të shkaktuara nga administrimi i paligjshëm, përfshirë çështjet lidhur me AGL-në, certifikimin dhe aksesin në kantier. Megjithatë, MIE ka zgjedhur të mosveprojë, në kundërshtim me detyrimet e saj kontraktore.

Në konkluzion, MIE nuk mund të mbështetet në një mospërmbyllje për të cilën ajo vetë ka krijuar ose ka rënduar kushtet, për ta ushtruar më pas si bazë për zgjidhjen e Kontratës ndaj Koncesionarit. Neni 422 i Kodit Civil kërkon që palët të veprojnë me korrektesë, paanësi dhe në përputhje me kërkesat e arsyes, ndërsa neni 682 kërkon interpretimin dhe përmbushjen e kontratës në mirëbesim. Gjithashtu, nenet 491–493 përjashtojnë përgjegjësinë e debitorit ose e reduktojnë atë kur mospërmbyllja, pamundësia e përmbushjes apo dëmi lidhet



me veprimet ose mosveprimet e vetë kreditorit. Nenet 11.9 dhe 13 të Kontratës vendosin mbi MIE-në detyrime të posaçme lidhur me veprimet e Autoriteteve Kompetente dhe parashikojnë trajtimin e veprimeve ose mosveprimeve të tyre që ndikojnë materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme mbi Projektin si Veprime Materiale të Pafavorshme Qeveritare, me pasoja kontraktore për Autoritetin Kontraktues. Për rrjedhojë, MIE nuk mund ta bazojë zgjidhjen e Kontratës pikërisht mbi pasojat e një situatë për të cilën Kontrata i atribuon asaj përgjegjësi ose së paku i ngarkon detyrimin për ta parandaluar ose korrigjuar. Një interpretim i tillë do t'i lejonte MIE-së të përfitonte nga pasojat e mospërmbushjes së saj, në kundërshtim me nenet 422 dhe 682 të Kodit Civil dhe me vetë qëllimin e mekanizmit kontraktor të parashikuar në nenet 11.9 dhe 13. MIE nuk mund të krijojë kushtet e mospërmbushjes, të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të saj përballë këtyre rrethanave dhe më pas ta përdorë rezultatin e këtij dështimi si justifikim për zgjidhjen e Kontratës.

Vlerësimi i përgjegjësisë për mosarritjen e Datës së Operimit nuk mund të bëhet duke fotografuar vetëm gjendjen përfundimtare të Projektit dhe duke injoruar sjelljen konkrete të Mabco-së për parandalimin, kufizimin dhe kapërcimin e vonesave. Dokumentacioni i administruar tregon se Mabco, në cilësinë e ortakut me 98% të kuotave, investitorit, financuesit, garantuesit dhe nënkontraktorit kryesor për terminalin dhe objektet përkatëse, pavarësisht pengesave të mëdha, ka ndërmarrë dhe financuar vazhdimisht masa për të ruajtur vazhdimësinë e Projektit, ndërsa ka kërkuar në mënyrë të përsëritur bashkëpunimin e VIA-së, MIE-së dhe Autoriteteve Kompetente. Këto masa përbëjnë prova të drejtpërdrejta të përpjekjeve për përmbushje dhe të detyrimit për minimizimin e dëmit, dhe nuk mund të anashkalohen në analizën e nenit 15.4 të Kontratës.

Mabco lidhi me Munich Airport International GmbH një marrëveshje për shërbime të menaxhimit teknik dhe ekspertizë aeroportuale, në zbatim të së cilës u financuan dhe u realizuan produkte teknike me vlerë mbi 1.5 milion euro. Pas vendosjes së masave gjyqësore që e privuan Mabco-në nga kontrolli efektiv i investimit, emërimit të administrimit të kontestuar dhe krijimit të pasigurisë reale se investitori kryesor mund të mbetej jashtë qeverisjes së Projektit, Munich Airport International nuk mundi të vijonte angazhimin në të njëjtat kushte. Kjo nuk përbën mungesë kujdesi nga Mabco, por pasojë të drejtpërdrejtë të pasigurisë juridike dhe institucionale të krijuar rreth VIA-së.

Megjithatë, Mabco nuk e la Projektin pa mbështetje aeroportuale. Më 22.01.2026 ajo **angazhoi daa International (Dublin Airport Authority) me një Engagement Letter për shërbime teknike, certifikimi, ORAT dhe përgatitje operative**. MIE u njoftua më 23.02.2026 për vizitën teknike të delegacionit të daa-së të planifikuar për datat 24–26.02.2026. Mabco kërkoi ndërhyrjen e MIE-së dhe të Kryeministrit. Mabco vijon ta mbajë dhe financojë marrëveshjen me daa-në, e cila mbetet e gatshme të kryejë funksionet e dakordësuara sapo të sigurohen kushtet ligjore, korporative dhe fizike për veprim. Për rrjedhojë, MIE nuk mund të reklamojë mungesën e operatorit duke injoruar se operatori i kualifikuar ishte angazhuar dhe financuar nga Mabco.

Leja fillestare e ndërtimit dhe aplikimi përkatës u bazuan në Masterplanin fillestar, i cili parashikonte një terminal ndjeshëm më të vogël. **Gjatë zhvillimit të Projektit, Kryeministri, në cilësinë e Kryetarit të KKT-së, miratoi dhe nënshkroi në rendera dhe layout-e një ndryshim material të zgjidhjes së terminalit, duke e çuar sipërfaqen e tij, sipas dokumentacionit teknik, në rreth 22,000 m² dhe duke shtuar, ndër të tjera, një kat mezzanine prej rreth 5,000 m², dy ura lidhëse për pasagjerët (link bridges) dhe ndryshime të tjera funksionale.**

Mabco kishte përgatitur vendimmarrjen e nevojshme për vazhdimin e kontratës me projektuesin X-Plan dhe për aplikimin për modifikimin/zgjerimin e lejes së ndërtimit në mbledhjen e Asamblesë së planifikuar për datën 20.10.2025. Vendimi gjyqësor i datës 17.10.2025 e bëri të pamundur marrjen e kësaj vendimmarrjeje. Më pas, Mabco kërkoi që procedura të realizohej përmes administratorit të regjistruar, por



autorizimi i domosdoshëm për aplikimin në e-Leje/e-Albania u refuzua ose nuk u dha. Pa pritur pasivisht, Mabco organizoi dhe financoi vetë përgatitjen e dokumentacionit teknik, kërkoi autorizimin e VIA-së më 21.04.2026, kërkoi ndërhyrjen e MIE-së më 05.05.2026 dhe iu drejtua së bashku AZHT-së dhe MIE-së më 08.05.2026 për një rrugë procedurale të ligjshme. Pavarësisht dijenisë së plotë, MIE nuk siguroi autorizimin e VIA-së dhe as një mekanizëm alternativ të zbatueshëm. Në këto rrethana, mungesa e përditësimit formal të lejes nuk mund të paraqitet sot si mospërbushje e Mabco-së, pa u vlerësuar pengesa gjyqësore, refuzimi i administrimit të VIA-së dhe mosveprimi i Autoritetit Kontraktues.

Edhe pasi u privua nga informacioni dhe vendimmarrja e VIA-së, Mabco vijoi të kontraktonte, paguante dhe mobilizonte pajisje dhe specialistë të domosdoshëm për certifikimin. Ajo siguroi sistemet e sigurisë aeroportuale SAS/X-Ray, EDS dhe detektorët; kërkoi bashkëpunimin e VIA-së për importin, zhdoganimin, pagesat fiskale, aksesin dhe instalimin; kërkoi lirimin e mjeteve zjarrfikëse të mbetura në doganë; kërkoi pagesat për ICT, GSE, operatorin aeroportual dhe pajisje të tjera certifikuese; dhe kërkoi vijimin e punimeve AGL nga furnitorët dhe specialistët ndërkombëtarë.

Në të njëjtën kohë, lidhja e përhershme me energji elektrike, furnizimi me ujë dhe kanalizime, si dhe lidhja e të dhënave/internetit — shërbime të domosdoshme për testimin, komisionimin, ICT-në, sigurinë, sistemet kundër zjarrit dhe certifikimin — nuk ishin siguruar në mënyrë të plotë, ndonëse neni 11.7 i Kontratës i ngarkon Autoritetit Kontraktues detyrime të posaçme lidhur me lidhjen e Kantierit me rrjetet publike deri në perimetrin e tij. Pavarësisht kësaj, Mabco vijoi punimet në kushte të jashtëzakonshme, duke përdorur zgjidhje të përkohshme, përfshirë gjeneratorë, dhe e çoi veçanërisht terminalin dhe objektet brenda fushës së saj në një fazë shumë të avancuar. MIE nuk mund të injorojë këtë dallim dhe të ngatërrojë punimet ende të mbetura me mungesën e vullnetit për përbushje.

Mabco u përjashtua jo vetëm nga kantieri, por edhe nga rrjedha e informacionit teknik dhe nga takimet ku duhej të trajtoheshin afatet, projektimi, certifikimi dhe punimet e mbetura. Ajo kundërshtoi përjashtimin e përfaqësuesve të saj nga takimi i datës 12.01.2026; kundërshtoi komunikimet e Inxhinierit të Pavarur të dërguara MIE-së, VIA-së dhe 2A Group pa përfshirë Mabco-n; dhe kundërshtoi mënyrën e administrimit të takimit dhe të *Minutes of Meeting* të datës 15.04.2026. Për të gjetur zgjidhje, ajo iu drejtua jo vetëm MIE-së, por edhe Kryeministrit, Avokaturës së Shtetit, AZHT-së, Autoritetit të Aviacionit Civil, Albcontrol-it, Policisë së Shtetit, QKB-së dhe organeve të prokurorisë. Pavarësisht këtij përshkallëzimi institucional, nuk u sigurua në kohë një mekanizëm efektiv që të rivendoste informacionin, aksesin, koordinimin dhe vendimmarrjen e nevojshme për përfundimin e Projektit.

Pas vendimit nr. 338, datë 26.05.2026, të Gjykatës së Lartë, Mabco përdori mekanizmin korporativ dhe jo vetëgjyqësinë: thirri Asamblenë për datën 06.06.2026, me qëllim shkarkimin e administratorit të kontestuar dhe emërimin e z. Max Schintlmeister, një profesionist me rreth tridhjetë vjet përvojë ndërkombëtare në aviacion dhe menaxhim aeroportual, i cili do të sillte vlerë të shtuar jo vetëm për VIA-n, por edhe për procesin e certifikimit dhe operimit. Një ditë përpara mbledhjes, në procesin e iniciuar nga 2A Group dhe në një kontekst ku Avokatura e Shtetit kishte ndërhyrë për “ruajtjen e status quo-së”, Gjykata e Shkallës së Parë vendosi masën e datës 05.06.2026, e cila e bëri të pamundur realizimin e këtij ndryshimi. MIE, ndonëse ishte vënë në dijeni se normalizimi i administrimit ishte kusht praktik për përbushjen e Kontratës, nuk ndërmori masa efektive për ta mbështetur atë.

Pa paragjykuar debatin procedural ndërmjet palëve mbi shtrirjen e masës së datës 05.06.2026 dhe efektet e vendimit të datës 06.07.2026 që e ngushtoi atë, Mabco thirri dhe dokumentoi më tej mbledhjet e Asamblesë të datave 18.06.2026, 04.07.2026 dhe 17.07.2026. Vendimet e marra synonin drejtpërdrejt përbushjen

b

e kërkesave të MIE-së dhe mbrojtjen e vazhdimësisë së Kontratës: ndalimin e çdo aderimi të VIA-së në financimin Delphos pa miratimet e nevojshme; dorëzimin e dokumentacionit teknik, financiar dhe kontraktor; rikthimin e Mabco-së dhe specialistëve të saj në kantier; vijimin dhe përfundimin e punimeve; auditimin e pavarur teknik e financiar; verifikimin e kontratave dhe pagesave; trajtimin e lejes së ndërtimit; mbrojtjen e aseteve; dhe rregullimin e sigurisë fizike të kantierit. Këto vendime iu komunikuan administratorit të regjistruar, 2A Group, MIE-së, Avokaturës së Shtetit, Policisë së Shtetit, QKB-së dhe institucioneve të tjera relevante.

Megjithatë, QKB-ja kërkoi që regjistrimet të kryheshin përmes kanalit elektronik të kontrolluar nga i njëjti administrator, duke krijuar një cirk vicioz; Policia e Shtetit pengoi hyrjen në kantier pavarësisht vendimmarrjeve të organit më të lartë drejtues të shoqërisë VIA; ndërsa kërkesat dhe kallëzimet drejtuar organeve të tjera nuk prodhuan në kohë masa mbrojtëse efektive


Ky zinxhir veprimesh provon se Mabco, ortakut që zotëron 98% të kuotave të shoqërisë “Vlora International Airport”, ka marrë masa konkrete, të kushtueshme dhe të vazhdueshme për të shpëtuar Projektin: ka siguruar operatorë dhe ekspertë ndërkombëtarë, ka financuar projektimin dhe ndryshimet e kërkuara, ka përgatitur përditësimin e lejes, ka kontraktuar pajisjet e certifikimit, ka ruajtur mobilizimin e furnitorëve, ka kërkuar auditim, ka vijuar punimet në mungesë të shërbimeve bazë dhe ka aktivizuar të gjitha rrugët korporative, administrative, gjyqësore dhe diplomatike të disponueshme. MIE ka qenë në dijeni të këtyre hapave. Për rrjedhojë, përpara se të konsideronte zgjidhjen e Kontratës, MIE duhej të vlerësonte masat e minimizimit, të garantonte bashkëpunimin e Autoriteteve Kompetente, të ndihmonte në rivendosjen e qeverisjes funksionale, të trajtonte ndryshimet e Projektit dhe të negocionte në mirëbesim një program rikuperimi dhe zgjatjen përkatëse të afateve. Zgjidhja e Kontratës pa këtë analizë e këput lidhjen e shkakësisë nga faktet dhe e ngarkon Mabco-n me pasojat e pengesave që ajo i ka denoncuar dhe është përpjekur vazhdimisht t’i kapërcejë.

MIE ka detyrimin pozitiv të bashkëpunimit dhe mosrëndimit të situatës së shoqërisë koncesionare. Siç është shprehur edhe Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, konflikti ligjor mes ortakut me 2% dhe ortakut me 98% të kuotave të VIA-së nuk është një konflikt i një shoqërie të thjeshtë e të zakonshme që mund të shihet vetëm në raport me ligjin për shoqëritë tregtare, ai duhet parë domosdoshmërisht i lidhur me ligjin për koncesionet dhe duhet trajtuar i tillë nga gjykatat dhe autoritetet.¹ Ortakët e shoqërisë nuk ushtrojnë një veprimtari të zakonshme tregtare, por janë Bashkim Operatorësh Ekonomikë që kanë si qëllim zbatimin e një kontrate koncesionare me Shtetin, sipas ligjit nr. 125/2013 “Për Koncesionet dhe Partneritetin Publik Privat”. Si i tillë, Enti Prokurues, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ruan të drejtën dhe detyrimin të ndërhyjë në interes të ligjit dhe të interesit kombëtar, nëse vlerëson se mosmarrëveshjet ndërmjet ortakëve cenojnë elementet e kontratës koncesionare.²

MIE shprehet se nga njëra anë Mabco pretendon se: “një pjesë e punimeve nuk ishin realizuar në përputhje me kërkesat kontraktuale dhe standardet e cilësisë, si dhe se administrata e Shoqërisë Koncesionare kishte krijuar pengesa administrative e operative në kantier.” (fq. 3 e Njoftimit), dhe nga ana tjetër: “Shoqëria Koncesionare e ka lidhur vonesën kryesisht me sjelljen dhe performancën e ortakut e kontraktorit “Mabco Constructions SA”, duke iu referuar një njoftimi “Notice to Correct” të datës 08.04.2026 për shkelje të rëndë materiale të kontratës, së ndërtimit të datës 03.10.2022 lidhur mes Shoqërisë Koncesionare dhe shoqërisë Mabco Constructions SA, përfshirë mosdorëzimin e garancisë së performacës, tejkalimin e afateve me dëmë vonese

¹ Vendimi nr. 338, datë 26.05.2026, i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, para. 44.

² Id., para. 46



që kanë arritur mbi 4.29 milionë euro dhe ndryshime të paautorizuara në projekt.” (fq. 3-4 e Njoftimit), ku MIE konkludon se: “brenda vetë strukturës së Shoqërisë Koncesionare ekziston mosnjohje e marrëdhënies kontraktore të ndërtimit, e cila ka ndikuar drejtpërdrejt realizimin dhe përfundimin në kohë të punimeve.” (fq. 4 e Njoftimit). Ajo çfarë shihet qartë nga ky prezantim i fakteve, nuk janë shkaqet e mos përfundimit në kohë të punimeve, por mosveprimi i MIE-së. Në dritën e arsytimit të Gjykatës së Lartë, MIE, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, nuk mund të mjaftojë me evidentimin e konfliktit ndërmjet ortakëve, por duhet të verifikonte në mënyrë të pavarur pretendimet e Mabco-së lidhur me cilësinë dhe përputhshmërinë e punimeve të kryera nga 2A Group, njësoj siç duhet të verifikonte pretendimet e administratorit Vegim Hoxha nëse veprimet ose mosveprimet e Mabco-së po shkaktonin realisht një dëm të rëndë ndaj Projektit. Mbi bazën e këtyre verifikimeve, MIE duhet të ndërmerre masat konkrete të nevojshme për rivendosjen e kushteve për zbatimin e rregullt të Kontratës së Koncesionit dhe për garantimin e vijimësisë së Projektit. Në vend të kësaj, dhe pavarësisht se ishte vënë në dijeni në mënyrë të përsëritur për pasojat e konfliktit, MIE nuk identifikon në Njoftimin e saj asnjë masë konkrete të ndërmarrë për të verifikuar këto pretendime, për të zgjidhur situatën ose për të parandaluar përkeqësimin e saj. Pra, ajo që MIE e paraqet si shkak të mospërfundimit të punimeve është, në fakt, edhe prova më e qartë e dështimit të saj për të përmbushur detyrimin pozitiv për të ndërhyrë në mbrojtje të Projektit. Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizohet në rolin e një vëzhguesi pasiv të një situatë që po pengon zbatimin e Kontratës dhe më pas t’ia atribuojë Koncesionarit pasojat e kësaj situatë, veçanërisht kur vetë Kontrata dhe kuadri ligjor i japin MIE-së mjetet dhe i ngarkojnë detyrimin për të vepruar.

Në shkresën e saj, MIE pretendon se *“Mospërmbushja e mësipërme nuk është rrjedhojë e ndonjë veprimi ose mosveprimi të Autoritetit Kontraktues, kjo mbështetet edhe nga vetë deklarata me shkrim e Shoqërisë Koncesionare...”* (fq. 2 e Njoftimit). Gjithashtu, MIE shprehet se: *“Theksohet se Shoqëria Koncesionare, ka pretenduar se veprimet e sipërmendura kanë prodhuar pasoja serioze për administrimin e projektit, sigurinë në kantier, ka krijuar pasiguri juridike në administrimin e projektit, ka rrezikuar vazhdimësinë e procesit të ndërtimit dhe vijueshmërinë e zbatimit të Kontratës së Koncesionit.”* (fq. 4 e Njoftimit). Megjithatë, pretendimet e Vegim Hoxhës nuk përbëjnë qëndrimin e shoqërisë koncesionare. Por në çdo rast, ky qëndrim është tërësisht i pabazuar në faktet e çështjes.

Së pari, shkresa të cilën citon MIE, është dërguar nga Vegim Hoxha, administratori i emëruar nga ortaku me 2% të kuotave, nëpërmjet vendimit të pavlefshëm të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, pasi nuk ishte përmbushur kuorumi i kërkuar nga neni 86 i ligjit nr. 9901/2008 *“Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”*. Siç Mabco e ka vënë MIE-në në dijeni që prej momentit të parë të emërimit të Vegim Hoxhës, si dhe nëpërmjet shkresave vijuese të shumta, vendimi nëpërmjet të cilit është emëruar Vegim Hoxha është një veprim absolutisht i pavlefshëm, bazuar në nenin 92 të Kodit Civil. Në këtë drejtim, neni 12, pika 4, i ligjit nr. 9901/2008 parashikon se parregullsitë në emërimin e përfaqësuesit ligjor nuk mund t’i kundrejtohen palëve të treta, përveç rasteve kur shoqëria provon se pala e tretë ka pasur dijeni për këto parregullsi ose, bazuar në rrethanat të qarta, nuk mund të mos kishte pasur dijeni për to. Në të njëjtin kuptim, neni 21, pika 3, e ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, *“Për Regjistrimin e Biznesit”* parashikon se i treti nuk mund t’i kundrejtojë subjektit të dhënat e regjistruara e të publikuara në rastet kur ai ka pasur dijeni për pasaktësinë e të dhënave të publikuara. Në rastin konkret, MIE është informuar në mënyrë të vazhdueshme për pavlefshmërinë e emërimit të Vegim Hoxhës, që në momentin e parë të regjistrimit të paligjshëm nga QKB-ja. Për rrjedhojë, MIE nuk mund të pretendojë se ky qëndrim, vjen nga shoqëria koncesionare.

Së dyti, edhe nëse do e merrnim të mirëqenë se Vegim Hoxha është administratori i shoqërisë koncesionare, shkresa e tij, dhe deklarata e lëshuar në emër të VIA-së, është ndërmarr *ultra vires*. Neni 16.6 i statutit të shoqërisë parashikon se administratori duhet të informojë ortakët për çdo veprim dhe të marrë paraprakisht miratimin e tyre për çdo veprim që ndërmerret në cilësinë e administratorit. Gjithashtu, kompetencat e



administratorit limitohen në përfaqësimin e zakonshëm të shoqërisë dhe menaxhimin e saj nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, bazuar në nenin 17 të statutit të shoqërisë. Përsëri, MIE nuk mund të pretendojë padijeninë e saj mbi dispozitat e mësipërme statutores, pasi statuti i shoqërisë është publikuar rregullisht pranë QKB-së, por edhe si pjesë e veprimtarisë së saj monitoruese të koncesionit MIE duhet të jetë në dijeni të dispozitave statutores. Në çdo rast, këto kufizime janë vënë në dijeni të MIE-së nga ana e Mabco-së, edhe përpara vendimit të Gjykatës së Lartë. Rrjedhimisht, MIE, nuk mund të bazohet te pretendimet e Vegim Hoxhës në lidhje me situatën e projektit koncesionar.

Së treti, faktet flasin vetë (*facta probant se ipsa*). Deklarimet e pabazuara të një administratori ilegjitim nuk mund të mbivendosin faktet e dokumentuara dhe të komunikuar në mënyrë të përsëritur nga Mabco. Të gjitha Veprimet Materiale të Pafavorshme Qeveritare të sipërcituara i janë bërë menjëherë me dije MIE-së, pavarësisht qëndrimit të vazhdueshëm të saj për t'i injoruar ato. Për këto arsye, mbështetja e MIE-së mbi këtë deklaratë nuk mund të shërbejë si bazë për transferimin e përgjegjësisë kontraktore nga MIE te një administrim i kontestuar dhe as për të neutralizuar provat e njoftimit, pengesave dhe mosveprimit institucional.

Në njoftimin e saj, MIE shprehet se: *“Kjo situatë konfliktuale, e vazhdueshme dhe në rëndim e sipër, ka vijuar, edhe pse në mirëbesim nga ana e Autoritetit Kontraktues, është kërkuar që çalët brenda një afati dhe me njëra-tjetrën të gjenin marrëveshje për të garantuar moscenimin e ecures së zbatimit të detyrimeve të kontratës koncesionare, për shkak të konflikteve të tyre.”* (fq. 5 e Njoftimi). Ky pretendim nuk mund të shërbejë si justifikim për përmbushjen e detyrimeve të MIE-së. Autoriteti Kontraktues nuk mund t'i reduktojë detyrimet e tij kontraktore në dërgimin e një kërkesë drejtuar ortakëve për të zgjidhur një konflikt, veçanërisht kur pasojat që po pengojnë zbatimin e Projektit nuk burojnë vetëm nga ky konflikt, por janë shkaktuar dhe rënduar nga Veprime Materiale të Pafavorshme Qeveritare. Përveç detyrimeve të përgjithshme të bashkëpunimit dhe garantimit të vazhdimësisë sipas neneve 11.4 dhe 11.9 të Kontratës, neni 13.3 i ngarkon MIE-së detyrimin për të reaguar ndaj një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar. Pas njoftimit për ndodhjen ose mundësinë e ndodhjes së një veprimi të tillë, MIE duhet, brenda 30 Ditëve Pune, të angazhohet me palët për të gjetur në mirëbesim një zgjidhje reciprokisht të pranueshme, me qëllim rivendosjen e Koncesionarit në pozicionin tregtar që do të kishte nëse Veprimi Material i Pafavorshëm Qeveritar nuk do të kishte ndodhur. Mabco i ka njoftuar në mënyrë të përsëritur MIE-së për këto veprime, pasojat e tyre dhe dëmin e shkaktuar, përfshirë fillimin e procedurave për kompensimin e tij sipas neneve 13.4 dhe 16 të Kontratës. Megjithatë, MIE nuk ka ndërmarrë asnjë nga veprimet që kërkon ky mekanizëm kontraktor. Ajo nuk ka ndërhyrë për të korrigjuar ose zbutur pasojat e masave të sigurimit të padisë, nuk ka marrë masa për rivendosjen e të drejtave të Mabco-së pas vendimit të Gjykatës së Lartë që i shpalli ato të paligjshme dhe nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret lidhur me pretendimet për pengimin e zhvillimit të punimeve në kantier. Në vend të kësaj, MIE ka zgjedhur ta reduktojë çështjen në një “konflikt midis ortakëve” dhe t'u kërkojë atyre të arrijnë një marrëveshje, edhe pse mosmarrëveshja ndërmjet tyre vijon të jetë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe, për rrjedhojë, nuk mund të zëvendësojë detyrimin e MIE-së për të adresuar pasojat konkrete që cenojnë zbatimin e Kontratës. Detyrimi i MIE-së ishte të vepronte për të garantuar vazhdimësinë e Projektit, jo t'ia delegonte Koncesionarit përgjegjësinë për zgjidhjen e një situatë të cilën vetë MIE kishte detyrimin kontraktor ta administronte. Aq më pak mund të konsiderohet përmbushje e këtij detyrimi kërkesa për arritjen e një marrëveshje që, në rrethanat konkrete, ishte objektivisht e pamundur të arrihej.

Edhe pse marrëveshja e huas me Delphos Securities nuk është parashtruar nga MIE si shkak për zgjidhjen e Kontratës së Koncesionit, MIE e ka përdorur atë në Njoftimin e saj për të mbështetur pretendimin se konflikti ndërmjet ortakëve ka ndikuar në funksionimin e Shoqërisë Koncesionare dhe në aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet kontraktore, duke u shprehur se *“...transferimin e kuotave si dhe marrëveshjen e huasë,*



kanë çuar në përshkallëzimin e konfliktit ndërmjet tyre. Këto mosmarrëveshje kanë ndikuar drejtpërdrejt në funksionimin e Shoqërisë Koncesionare dhe në aftësinë e saj për të përmbushur detyrimet kontraktore të marrë përsipër sipas Kontratës së Koncesionit.” (fq. 5 e Njoftimit). Megjithatë, ky pretendim është i pabazuar. Pasi, ajo çfarë ka ndikuar në funksionimin e shoqërisë nuk është marrëveshja e financimit e Delphos, por është përdorimi i saj nga ortakët me 2% të kuotave për të marrë 3 masa sigurimi të paligjshme me pretendimet e pabazuara të ekzistencës së rrezikut nga huaja e Delphos, si dhe nga ana e Avokaturës së Shtetit e cila ka kërkuar marrjen e masës së sigurimit të padisë 1 ditë përpara zhvillimit të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve të VIA-së. Gjithashtu, ka ndikuar në dhënien e masës së sigurimit të padisë së datës 05.06.2026, edhe shkresa e datës 03.06.2026 e MIE-së, ku 3 ditë përpara mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve shpreh “shqetësimet” e saj, ndonëse ka qenë në dijeni të kësaj marrëveshje muaj më përpara. Neni 23.2 i marrëveshjes së financimit të Delphos parashikon qartë se çdo aderim i koncesionarit kërkon miratimin paraprak të Ministrisë, ndërkohë që neni 19.3 i Kontratës së Koncesionit dhe legjislacioni në fuqi kushtëzojnë vlefshmërinë e çdo marrëveshjeje financimi me përfshirjen dhe miratimin e autoritetit kontraktor. Ky interpretim është konfirmuar edhe nga vetë huadhënësi Delphos, i cili ka njohur shprehimisht se çdo aderim i VIA-së në marrëveshjen e financimit është i kushtëzuar nga miratimi i Autoritetit Kontraktor. Për më tepër pretendimet në lidhje me marrëveshjen e Delphos, kanë marrë zgjidhje përfundimtare nga ana e Gjykatës së Lartë. E cila në vendimin e saj është shprehur se pretendimet e palëve në lidhje me kontratën e huas të datës 26.03.2025, të lidhur ndërmjet "Mabco Constructions" S.A. dhe "Delphos Securities SARL Compartment Bernina", rrëzohen përfundimisht si të pabazuara dhe në kundërshtim me ligjin.³ Kolegji arsyetoi se Aeroporti Ndërkombëtar i Vlorës është pronë e Republikës së Shqipërisë dhe as VIA dhe as ortakët e saj nuk mund të vënë si garanci një pasuri që nuk është në pronësinë e tyre dhe as në qarkullim civil, çdo veprim i tillë, pa miratimin e Shtetit Shqiptar, është absolutisht i pavlefshëm, nul dhe i paqenë, duke mos prodhuar asnjë pasojë juridike.⁴ Për rrjedhojë, nuk ishte marrëveshja e financimit me Delphos, në vetvete, ajo që ndikoi negativisht në funksionimin e Koncesionarit apo në zbatimin e Projektit, por veprimet e ndërmarra mbi bazën e pretendimeve lidhur me këtë marrëveshje të ortakut me 2% të kuotave, Autoriteteve Kompetente (Gjykatat dhe Avokatura e Shtetit), si dhe vetë Autoriteti Kontraktues, të cilat kanë pasur ndikim negativ mbi koncesionin dhe përfundimin e punimeve.

B. Në lidhje me pretendimin e MIE-së për mosmbajtjen në fuqi të Sigurimit të Kontratës

Në shkresën e saj, MIE pretendon se: “Autoriteti Kontraktues i ka kërkuar Shoqërisë Koncesionare, me shkresën nr. 6080 prot., datë 16.07.2026, përcjelljen e Formularit të vlefshëm të Sigurimit të Kontratës brenda 5 (pesë) ditëve...Shoqëria Koncesionare nuk ka përcjellë pranë Autoritetit Kontraktues formularin e rinovuar dhe të vlefshëm të Sigurimit të Kontratës. Mospërcjellja dhe mosmbajtja në fuqi e Sigurimit të Kontratës përbën shkelje të nenit 10.68 dhe e lë Autoritetin Kontraktues pa garancinë kontraktore të parashikuar për mbrojtjen e interesave të tij, duke përbërë mospërmbushje thelbësore të detyrimeve kontraktore.” (fq. 6 e Njoftimi). Megjithatë, edhe nëse do merrnim të mirëqenë se koncesionari nuk e ka përmbushur detyrimin e tij kontraktor, mospagimi i sigurimit të kontratës nuk është një shkelje materiale. Vetë fakti që neni 10.68 parashikon detyrimin për mbajtjen në fuqi të Sigurimit të Kontratës nuk e shndërron automatikisht çdo vonesë ose mangësi në rinovimin e tij në një mospërmbushje thelbësore. Për më tepër, MIE nuk identifikon asnjë dëm konkret të shkaktuar nga mosrinovimi i pretenduar dhe as ndonjë cenim real të aftësisë së saj për të ushtruar të drejtat që i burojnë nga Kontrata. Për rrjedhojë, një mangësi e tillë, e cila është në vetvete e kurueshme, nuk mund të barazohet me një shkelje të natyrës dhe peshës së tillë që të cenojë në mënyrë thelbësore Kontratën.

³ Vendimi nr. 338, datë 26.05.2026, i Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë, para. 71.

⁴ *Id.* para. 79.



Në çdo rast, kjo situatë nuk mund t'i atribuohet Koncesionarit pa marrë parasysh rrethanat konkrete që kanë çuar në të. Edhe po të merrej e mirëqenë se Sigurimi i Kontratës nuk është mbajtur në fuqi për shkak të mosveprimeve të administratorit të emëruar nga ortakët që zotëron 2% të kuotave, MIE nuk mund të mbështetet në këto mosveprime si bazë për zgjidhjen e Kontratës. Siç i është bërë me dije në mënyrë të përsëritur, emërimi i këtij administratori dhe regjistrimi i tij nga QKB-ja, në kundërshtim me kërkesat ligjore, i janë parashtruar MIE-së që prej regjistrimit të tij, më datë 15.12.2025. Për rrjedhojë, MIE ka qenë në dijeni prej kohësh se personi që ushtronte administrimin e Shoqërisë Koncesionare ishte i kontestuar dhe nuk mund të mbështetet tani në pasojat e veprimeve ose mosveprimeve të një administratori, emërimin e të cilit e kishte në dijeni se ishte i kundërshtuar dhe i paligjshëm.

Për më tepër, mosmbajtja në fuqi e Sigurimit të Kontratës nuk përbën, në vetvete, shkak për zgjidhjen e parakohshme të Kontratës. Neni 15.4 përcakton në mënyrë të shprehur shkeljet e Koncesionarit që mund të aktivizojnë të drejtën e zgjidhjes, ndërsa mosmbajtja në fuqi e Sigurimit të Kontratës nuk parashikohet si shkak i posaçëm në asnjërën prej tetë germave të këtij neni. Në çdo rast, edhe nëse do të pranohej se kjo përbën një mospërmbushje materiale, neni 15.4(h) kërkon që Koncesionarit t'i jepet një afat prej 60 ditësh nga marrja e njoftimit për të ndrequr shkeljen përpara se të mund të ushtrohet e drejta e zgjidhjes. MIE e ka njoftuar Koncesionarin për këtë pretendim vetëm më datë 16.07.2026. Për rrjedhojë, edhe nëse do të merrej e mirëqenë ekzistenca e një mospërmbushjeje kontraktore, MIE nuk mund të ushtrojë të drejtën e zgjidhjes përpara përfundimit të afatit të kurimit të parashikuar në nenin 15.4(h).

C. Në lidhje me pretendimin e MIE-së për mos pagesën e penaliteteve kontraktore

Në shkresën e saj, MIE shprehet se ndaj shoqërisë koncesionare: *"...Autoriteti Kontraktues ka kërkuar shlyerjen e penaliteteve kontraktore të pasqyruara në faturat për periudhat 20.02.2026-20.03.2026, 20.03.2026-20.04.2026, 20.04.2026-20.05.2026, 20.05.2026-20.06.2026, 20.06.2026-20.07.2026, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga marrja e shkresës, duke rezervuar të drejtën për ndjekjen e të gjitha mjeteve dhe procedurave të parashikuara në Kontratë dhe në legjislacionin në fuqi për arkëtimin e tyre në rast moslikuidimi. Aktualisht likuidimi i detyrimeve nuk është realizuar."* (fq. 6 e Njoftimit). Megjithatë, penaltetet kontraktore të lëshuara nga MIE janë në kundërshtim me nenin 10.17 të Kontratës së Koncesionit.

Së pari, neni 10.17(i) i Kontratës së Koncesionit përjashton shprehimisht pagimin e penaltetit kur Data e Operimit është penguar ose shtyrë si rezultat i një Veprimi Material të Pafavorshëm Qeveritar. Siç është parashtruar më sipër, vonesa në përfundimin e punimeve dhe, për rrjedhojë, në arritjen e Datës së Operimit, është shkaktuar dhe rënduar nga Veprime Materiale të Pafavorshme Qeveritare. Për rrjedhojë, kushti kontraktor për aplikimin e penalteteve sipas nenit 10.17 nuk është përmbushur dhe MIE nuk ka të drejtë t'i ngarkojë Koncesionarit këto penaltete.

Së dyti, edhe afati 15-ditor i pretenduar nga MIE nuk gjen mbështetje në Kontratë. Neni 10.17(ii) parashikon se penaltetet paguhen për një periudhë jo më të gjatë se 180 ditë pas lëshimit të faturës përkatëse nga Autoriteti Kontraktues. Fatura e parë është lëshuar më 20.03.2026, ndaj afati 180-ditor për pagesën e saj është data 20.09.2026. Për rrjedhojë, edhe nëse do të merrej e mirëqenë vlefshmëria e penalteteve dhe e faturave të lëshuara nga MIE, pretendimi se Koncesionari ndodhet në vonesë për pagesën e tyre brenda një afati 15-ditor nuk është i bazuar në nenin 10.17(ii).

Së treti, edhe nëse do të merrej e mirëqenë vlefshmëria e penalteteve të pretenduara, mosshlyerja e pesë faturave, në shumën totale prej 50,000 Euro, nuk përbën në vetvete një mospërmbushje materiale që mund të justifikojë zgjidhjen e Kontratës. Për më tepër, siç është parashtruar më sipër, mosshlyerja e pretenduar nuk



mund t'i atribuohet automatikisht Koncesionarit, pasi ajo lidhet me veprimet ose mosveprimet e administratorit të emëruar nga ortaku me 2% të kuotave, emërimi i të cilit është kundërshtuar dhe për paligjshmërinë e të cilit MIE ka qenë në dijeni që prej datës 15.12.2025. Për rrjedhojë, MIE nuk mund të përdorë si bazë për zgjidhjen e Kontratës një mosshlyerje të pretenduar, për të cilën ka qenë në dijeni se buronte nga administrimi i kontestuar i Shoqërisë Koncesionare dhe të cilën, pavarësisht kësaj, nuk ka ndërmarrë masa për ta adresuar.

D. Zgjidhja e Kontratës nga MIE është Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar


Neni 13.1 i Kontratës e përkufizon Veprimin Material të Pafavorshëm Qeveritar si rastet kur, Autoriteti Kontraktues ose ndonjë Autoritet Kompetent vendor apo qendror, pas Datës Efektive të kësaj Kontrate "*merr ose dështon të ndërmarrë një veprim, efekti i të cilit ndikon në mënyrë materiale dhe negativisht*" mbi Koncesionarin, në lidhje me të drejtat, aktivet, shpenzimet apo të ardhurat e tij, ose me pozicionin e tij ekonomik dhe financiar. Vetë neni e karakterizon këtë listë si jo shteruese. Zgjidhja e njëanshme e Kontratës e ndërmarrë nga MIE më datë 03.08.2026 prodhon pikërisht këtë efekt. Ajo i heq Koncesionarit, në mënyrë të menjëhershme dhe totale, të drejtat ekskluzive koncesionare të parashikuara në nenin 4, të drejtën për të projektuar, ndërtuar, komisionuar, operuar, mirëmbajtur dhe transferuar VIA-në, të drejtat reale mbi Sitin dhe të drejtën e Gëzimit të Plotë dhe të Qetë sipas nenit 7, si dhe çdo pritshmëri ekonomike dhe financiare të lidhur me realizimin e Projektit gjatë afatit prej 35 vjetësh të mbetur. Kur kjo shkëputje nuk mbështetet në një bazë të vlefshme kontraktore, sepse, siç kemi parashtruar në Pjesën A më sipër, kushtet e nenit 15.4 nuk janë përmbushur, pasi vetë mospërmbushja e pretenduar është shkaktuar apo rënduar nga veprime dhe mosveprime të Autoriteteve Kompetente për të cilat MIE mban përgjegjësi kontraktore. Atëherë veprimi i MIE-së nuk mund të kualifikohet thjesht si ushtrim i rregullt i një të drejte kontraktore. Në substancë, ai përbën një marrje faktike të të drejtave dhe aktiveve të Koncesionarit, analoge me shembullin e shprehur në nenin 13.1(a), pavarësisht emërimit formal "zgjidhje kontrate" që i është dhënë nga MIE. Prandaj, zgjidhja e parakohshme e Kontratës konsiderohet Veprim Material i Pafavorshëm Qeveritar.

Në këto kushte, duke vlerësuar se zgjidhja e parakohshme e Kontratës së Koncesionit është e pabazuar dhe nuk përmbush kushtet e parashikuara në Kontratë, kërkojmë që kjo mosmarrëveshje të zgjidhet nëpërmjet negociatave në mirëbesim, pa paragjykuar qëndrimin apo pretendimet e asnjërës palë, në përputhje me nenin 21.1 të Kontratës. Për këtë qëllim, propozojmë zhvillimin e negociatave brenda 15 Ditëve Pune nga data e marrjes dijeni të kësaj shkrese, pra jo më vonë se data **31 gusht 2026**.

Kjo shkresë nuk përbën heqje dorë nga asnjë e drejtë, pretendim, prapësim, mjet juridik apo mbrojtje që na takon nga Kontrata e Koncesionit, Marrëveshja Bilaterale ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane për nxitjen dhe mbrojtjen reciproke të investimeve si dhe nga legjislacioni kombëtar për mbrojtjen e investimeve të huaja. Ne rezervojmë shprehimisht çdo të drejtë sipas legjislacionit shqiptar, të drejtës ndërkombëtare dhe çdo mekanizmi tjetër ligjor të aplikueshëm.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

Me konsideratë,
Për shoqërinë "Mabco Constructions" S.A.


Z. Emin Pacolli
President i shoqërisë "Mabco Constructions" S.A.

Mabco Constructions SA
Via Cattori 7
CH - 6902 Lugano-Paradiso